

LIGJ PËR AVOKATINË SHTETËRORE

TEKST I KONSOLIDUAR **Ligj për avokatinë shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007 dhe 104/2015). Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë U. nr. 121/2010, i shpallur në "Gazetenë Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2010.**

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet: organizimi dhe kompetenca e Avokatisë Shtetërore të Republikës së Maqedonisë, kushtet dhe procedura për emerimin dhe shkarkimin e Avokatit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë dhe të avokatëve shtetërorë, autorizimet, të drejtat dhe obligimet e tyre, mjetet për punë, qasja te informatat, bashkëpunimi me organet e administratës shtetërore dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e tij.

Neni 2

Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim - Avokatia Shtetërore) është organ shtetëror cili ndërmerr masa dhe mjete juridike për shkak të mbrojtjes juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të Republikës së Maqedonisë dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë dhe tjetër ligj.

Neni 3

Avokatia Shtetërore i realizon kompetencat e saj në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare.

Neni 4

Funksionin e Avokatisë Shtetërore e kryen Avokati shtetëror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin në vijim - Avokati shtetëror) dhe avokatët shtetërorë në Avokatinë Shtetërore (në tekstin në vijim - avokatët shtetërorë).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e Avokatit Shtetëror, me vendim e përcakton numrin e avokatëve shtetërorë dhe merr vendim me të cilin e cakton selinë e avokatëve shtetërorë dhe rajonin e gjykatave ku kryhet funksioni i avokatisë shtetërore.

Gjatë marrjes së vendimit me të cilin përcaktohet numri i avokatëve shtetërorë, niset nga numri, lloji dhe karakteri i lëndëve, si dhe nga kompetenca e gjykatës në rajonin e së cilës avokatët shtetërorë e kryejnë funksionin e vet.

Selia e avokatëve shtetërorë dhe rajoni i gjykatave ku kryhen funksioni i avokatisë shtetërore, përcaktohet në bazë të arsyes ekonomike dhe numrit të gjykatave para të cilave avokati shtetëror ndërmerr veprime.

Neni 5

Avokati Shtetëror dhe avokatët shtetërorë i mbrojnë të drejtat pronësore dhe interesat e Republikës së Maqedonisë dhe organeve shtetërore të themeluara me ligj para gjykatave dhe organeve tjera në vend dhe në vendet e huaja.

Neni 6

Avokati Shtetëror mund të autorizojë edhe person të punësuar në Avokatinë Shtetëre me provimin e dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punë juridike të përfaqësojë para gjykatave dhe organeve tjera në konteste pronësore-juridike.

Avokati Shtetëror mund të autorizojë edhe person të punësuar në organin e administratës shtetërore me provimin e dhënë të jurisprudencës, i cili punon në punë juridike të administratës shtetërore të përfaqësojë para gjykatave dhe organeve tjera në kontestet pronësore-juridike.

Avokati Shtetëror nëse në pajtim me dispozitat e shtetit të huaj, nuk mund të përfaqësojë drejtëpërdrejt para gjykatave të tyre dhe organeve tjera, Qeveria e Republikës të Maqedonisë, me propozimin e Avokatit Shtetëror, do të autorizojë person tjetër i cili sipas dispozitave të shtetit, në lëndë të caktuar mund ta zëvendësojë në përfaqësimin.

Personat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij nenit veprojnë në kufijtë e autorizimeve që do t'u barten nga avokati shtetëror.

Neni 7

Avokatia Shtetërore është me seli në Shkup.

Avokatia Shtetërore ka vulën e vet në të cilën qëndron emri dhe selia, stema dhe emri Republika e Maqedonisë.

Në objektin në të cilin është vendosur Avokatia Shtetërore dhe avokatët shtetërorë vendoset emri dhe selia, stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë.

II. KOMPETENCA DHE ORGANIZIMI

Neni 8

Avokatët shtetërorë në kryerjen e funksionit të tyre janë të pavarur dhe për punën e tyre i përgjigjen Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Avokatit Shtetëror.

Neni 9

Avokati Shtetëror e prezanton dhe e përfaqëson Avokatinë Shtetërore, udhëheq dhe ndërmerr veprime për të cilat është i autorizuar me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Avokati Shtetëror për punën e tij dhe për punën e Avokatisë Shtetërore i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Kur Avokati Shtetëror mungon ose është i penguar ta realizojë funksionin e tij, atë e zëvendëson Avokat Shtetëror nga rajoni ku është selia e Avokatit Shtetëror dhe të cilin avokati shtetëror do ta caktojë me orarin vjetor për punë.

Avokati Shtetëror dhe avokatët shtetërorë janë të obliguar që ta ruajnë dinjitetin e funksionit që e kryejnë.

Neni 10

Avokatët shtetërorë ndërmarrin veprime para gjykatës, organit tjetër ose persona juridikë për të cilët me këtë ose tjetër ligj është i autorizuar Avokati Shtetëror.

Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë siguron të dhëna nga Agjencia për Kadastër të Patundshmërive në formë elektronike.

Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë, pa pagim të kompensimit, te Agjencia në formë elektronike i dërgon dokumentet për bazë juridike në bazë të së cilës bëhet regjistrimi në dobi të Republikës së Maqedonisë.

Neni 11

Avokati Shtetëror në raste të arsyeshme, sipas vlerësimit personal mund të mënjanjoë avokat shtetëror në rajonin adekuat nga veprimi sipas lëndës konkrete dhe të njëjtën t'ia besojë avokatit tjetër shtetëror.

Avokati Shtetëror me kërkesë të avokatëve shtetërorë ose me detyrë zyrtare, mund të mënjanjoë avokatë shtetërorë nga veprimi sipas lëndës së përcaktuar nga shkaqet e njëjta për të cilat mund të mënjanohet gjykatësi.

Neni 12

Organet e administratës shtetërore dhe personat juridikë janë të obliguar që Avokatisë Shtetërore t'i dorëzojnë të dhëna, dëshmi dhe informata për shkak të mbrojtjes juridike të të drejtave pronësore dhe interesave të Republikës së Maqedonisë për nevojat e veprimit sipas lëndës konkrete në afat prej pesë ditësh pune.

Të gjithë personat juridikë dhe fizik janë të obliguar që me kërkesën e Avokatit Shtetëror të dorëzojnë informata për mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe interesave të Republikës së Maqedonisë në afat prej pesë ditësh pune.

Neni 13

Avokati Shtetëror për çështjet e rëndësishme për realizimin e funksionit dhe për çështjet me interes të përbashkët bashkëpunon me organet e pushtetit shtetëror dhe me persona fizikë dhe juridikë.

Funksioni i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore është i obliguar të caktojë person i cili do ta përfaqësojë organin dhe do të bashkëpunojë me Avokatin Shtetëror dhe për këtë do ta njoftojë Avokatin Shtetëror.

Me kërkesën e funksionarit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, interes i të cilit mbrohet ose me propozimin e Avokatit Shtetëror, për konteste me rëndësi të veçantë, mund të caktohet person i cili detyrimisht duhet të marrë pjesë në seancat gjyqësore krahas avokatëve kompetentë shtetërorë.

Neni 14

Organet e administratës shtetërore nga neni 5 të këtij ligji e njoftojnë Avokatin Shtetëror për çdo kontest pronësor-juridik me personat fizikë dhe juridikë vendas apo të vendeve të huaja.

Njoftimi nga paragrafi (1) të këtij nenit dorëzohet më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga dita e paraqitjes për kontestin e krijuar.

Me njoftimin në të cilin përbahen të dhëna për palët, lëndën dhe vlera e kontestit, marrëdhënia juridike prej të cilit është shkaktuar kontesti dhe të dhënat tjera të nevojshme, detyrimisht dorëzohen edhe dëshmitë materiale me të cilat disponojnë.

Neni 15

Avokati Shtetëror para ndërmarrjes së veprimeve për ngritjen e procedurës para gjykatës, organ tjetër ose persona juridikë, në rastet kur kjo është e nevojshme ai është i obliguar që nga organi që e përfaqëson, të sigurojë pajtueshmërinë me shkrim për ngritjen e procedurës.

Në rastin kur organi të cilin e përfaqëson avokati shtetëror të mos japë pëlqim për ngritjen e procedurës, avokati shtetëror në kuadrin e autorizimeve të veta, në kuptim të nenit 2 të këtij ligji, vendos për ngritjen e procedurës nëse konsideron se janë cenuar interesat e Republikës së Maqedonisë.

Avokati Shtetëror para ngritjes së procedurës para gjykatës mund të ndërmarrë veprime të nevojshme për shkak të zgjidhjes me marrëveshje të kontestit të marrëdhënies juridike pronësore.

Personi i cili do të vendosë të ngritë procedurë kundër Republikës së Maqedonisë dhe organeve të administratës shtetërore, mund t'i drejtohet Avokatit Shtetëror dhe avokatëve shtetërorë për shkak të zgjidhjes me marrëveshje të marrëdhënies juridike pronësore nga i cili del kontesti i kriuar.

Avokati Shtetëror dhe avokatët shtetëror janë të obliguar që të deklarohen për propozimin për zgjidhje me marrëveshje në afatin më të shkurtër të mundshëm, por jo më vonë se tetë ditë pas marrjes së pajtueshmërisë nga organi të cilin e përfaqëson.

Në qoftë se në afat prej pesë ditësh pune nga dita e marrjes së njofimit të Avokatit Shtetëror dhe avokatëve shtetërorë organi nuk deklarohet, konsiderohet se nuk e pranon propozimin e dorëzuar nga personi përmes Avokatit Shtetëror për zgjidhje me marrëveshje të marrëdhënies kontestuese.

Neni 16

Nëse Avokati Shtetëror vlerëson se nuk duhet të ngrihet procedurë para gjykatës ose organit tjeter ose duhet të tjerhiqe padia, të heq dorë nga kërkesëpadia ose nga propozimi për zbatim, të pranohet kërkesa e palës së kundërt ose të lidhet barazim, të tjerhet ose të heq dorë nga e drejta e ankesës, si dhe të deklarojë mjete juridike të jashtëzakonshme, do të kërkojë nga organi i administratës shtetërore që e përfaqëson që të deklarohet përfaqësimi të mëtutjeshëm.

Nëse në afat prej pesë ditësh pune nga kërkesa e avokatit shtetëror, organi i administratës shtetërore nuk deklarohet për propozimin e avokatit shtetëror, do të konsiderohet se nuk pajtohet me propozimin e Avokatit Shtetëror.

Nëse ndërmjet Avokatit Shtetëror dhe organit të administratës shtetërore që e përfaqëson nuk arrihet pajtueshmëri për çështjet nga paragrafi 1 të këtij neni, Avokati Shtetëror do ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe do të kërkojë që Qeveria të deklarohet.

Neni 17

Shpenzimet përfaqësimin nga ana e Avokatit Shtetëror përcaktohen sipas Tarifës për shpërblimi dhe kompensimi të shpenzimeve përfaqësimin nga ana e avokatëve.

Mjetet të arkëtuara në emër të shpenzimeve përfaqësim janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

III. AVOKATI SHTETËROR DHE AVOKATËT SHTETËRORË

Neni 18

Avokatin Shtetëror me propozimin e ministrit të Drejtësisë e emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Avokati Shtetëror emërohet përfaqësimin nga ana e Avokatit Shtetëror, me të drejtë përfaqësimin e shpenzimeve përfaqësimin nga ana e avokatëve.

Avokatët shtetërorë i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mendim paraprakisht të siguruar nga Avokati Shtetëror, pa kufizimin e mandatit.

Neni 19

Qeveria e Republikës së Maqedonisë boton shpallje për emërimin e Avokatit Shtetëror dhe të avokatëve shtetërorë më së voni në afat prej 15 ditësh nga krijimi i kushteve për zgjedhje të avokatëve shtetërorë.

Procedura për emërimin dhe zgjedhjen e Avokatit Shtetëror dhe të avokatëve shtetërorë fillon 60 ditë para plotësimit të shkaqeve për pushim.

Shpallja nga paragrafi (1) i këtij neni bотohet së paku në dy gazeta ditore prej të cilave njëra është në gjuhën zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonishtë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

Neni 20

Avokat Shtetëror emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- të jetë jurist i diplomuar me përvojë pune të punëve juridike më së paku tetë vjet pas dhënieve të provimit të jurisprudencës, dhe
- të gëzojë autoritet për kryerjen e funksionit.

Avokatë shtetërorë emërohen persona të cilët duhet t'i plotësojnë kushtet e theksuara në alinenë 1 dhe 3 nga paragrafi 1 të këtij neni dhe të jenë juristë të diplomuar me përvojë pune në punë juridike së paku pesë vjet pas dhënieve të provimit të jurisprudencës.

Gjatë zgjedhjes së avokatëve shtetërorë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë e ka parasysh përfaqësimin e qytetarëve në mënyrë adekuate dhe të drejtë të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 21

Avokati Shtetëror para marrjes së funksionit jep deklaratë solemne para Kryetarit të Qeverisë së Republikës të Maqedonisë, si vijon: "Deklaroj se me punën time do t'i përbahem Kushtetutës dhe ligjeve dhe se do t'i mbroj të drejtat pronësore dhe interesat e Republikës së Maqedonisë dhe funksionin tim do ta kryej me ndërgjegje, me përgjegjësi dhe me nder".

Avokatët shtetërorë deklaratën solemne e japin para Avokatit Shtetëror.

Neni 22

Funksioni Avokat Shtetëror është jo koherent me kryerjen e funksioneve dhe profesioneve tjera publike.

Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në Avokatinë Shtetërore.

Neni 23

Funksioni	Avokat	Shtetëror	gjegjësish	avokatëve	shtetërorë	pushon:
-			me			vdekje,
-	me		kërkësën	e		vet,
-	për shkak	të plotësimit	të kushteve	për fitimin	së pensionit	të pleqërisë,
-	nëse	vërtetohet	se e ka humbur	në mënyrë	të përhershme	aftësinë për kryerje të funksionit,
-	nëse	është zgjedhur,	gjegjësish	emëruar	në funksion,	gjegjësish detyrë;
-	nëse	me aktgjykim	të plotfuqishëm	shpallet fajtor	dhe i	është kumtuar dënim efektiv me burgim prej së paku gjashtë muajsh.

Në rastet nga paragrafi 1 të këtij neni pushimin e funksionit të Avokatit Shtetëror dhe avokatëve shtetërorë e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 24

Avokatët shtetërorë mund të shkarkohen për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit Avokat Shtetëror.

Vendimin për shkarkim nga paragrafi 1 të këtij nenii me propozimin e Avokatit Shtetëror merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 25

Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund ta shkarkojë Avokatin Shtetëror për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit.

Kundër vendimit të Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për shkarkimin ose pushimin nga nenii 23, paragrafi 1, alineja 3-6 të këtij ligji të funksionit Avokat Shtetëror dhe avokatëve shtetërorë, mund të ngrihet kontest administrativ para Gjykatës Kushtetuese në afat prej 30 ditësh.

Neni 26

Vendimi për shkarkimin e Avokatit Shtetëror dhe të avokatëve shtetërorë shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Për shkarkimin njoftohet Avokati i shkarkuar Shtetëror, gjegjësisht avokatët shtetërorë dhe Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë.

Neni 27

Avokati Shtetëror, gjegjësisht avokatët shtetërorë të cilët janë të shkarkuar, realizojnë të drejta në bazë të punës në mënyrë dhe me kushte të parashikuara me ligj.

Neni 28

Avokati Shtetëror dhe avokatët shtetërorë kanë legjitimacione zyrtare.

Ministri i Drejtësisë e përcakton formën dhe përbajtjen e formularit, përbajtjen, procedurën dhe mënyrën e dhënies, shfrytëzimit dhe marrjes së legjitimacionit zyrtar.

Neni 29

Avokati Shtetëror, avokatët shtetërorë, nëpunësit shtetërorë, bashkëpunëtorët, praktikantët dhe të punësuarit tjerë në Avokatinë Shtetërore kanë të drejtë dhe obligim për aftësim dhe përsosje të pérhershme profesionale.

Për nevojat e përsosjes profesionale sigurohen mjete të veçanta në pjesën e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dedikuar për Avokatinë Shtetërore, si dhe nga burime tjera të mjeteve.

IV. NËPUNËS SHTETËRORË DHE TË PUNËSUAR TË TJERË NË AVOKATINË SHTETËRORE

Neni 30

Në Avokatinë Shtetërore punësohen nëpunës shtetërorë dhe punëtorë tjerë për kryerjen e punëve administrative profesionale.

Gjatë punësimit të nepunësve zyrtarë dhe punëtorëve të tjera për kryerjen e punëve administrative-profesionale do të zbatohet përfaqësimi përkatës dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 31

Me aktin e përgjithshëm për organizimin e punës së Avokatisë Shtetërore dhe me aktin përsistemimin e punëve dhe detyrave përcaktohen organizimi i brendshëm dhe numri i realizuesve, kushtet e veçanta që duhet t'i plotësojnë për themelin e marrëdhënies së punës dhe punët dhe detyrat që duhet t'i kryejnë.

V. MJETE PËR PUNË

Neni 32

Mjetet për punën e Avokatisë Shtetërore sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe burime tjera të financimit.

VI. QASJA TE INFORMATAT

Neni 33

Avokati Shtetëror, avokatët shtetërorë, nepunësit shtetërorë dhe të punësuarit tjerë në Avokatinë Shtetërore veprojnë në pajtim me Ligjin për Qasje të Lirë te Informatat me Karakter Publik, për veç kur bëhet fjalë për informata të klasikuara të përcaktuara me ligj.

Neni 34

Avokati Shtetëror për punën e Avokatisë Shtetërore së paku një herë në vit e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Raporti vjetor veçanërisht përban pasqyrën e lëndëve të pranuara, të zgjidhura, të pazgjidhura dhe pasqyrën e mjeteve juridike të dorëzuara dhe mjetet.

Në raportin vjetor mund të paralajmërohet për gjendjen dhe mangësitë në ligjvënie, në punën e brendshme të Avokatisë Shtetërore, gjykatat dhe organet të cilat i përfaqësojnë dhe me nevojë të jepen propozime adekuate për ndryshimin e ligjeve dhe akteve nënligjore.

Me kërkesën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Avokatia Shtetërore është e obliguar të dorëzojë raport për punën e saj ose veprimin sipas lëndës konkrete.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji Avokatia publike e Republikës së Maqedonisë vazhdon me punë si Avokati Shtetërore.

Avokati Publik dhe zëvendës-avokatët publikë, të cilët me fillimin e zbatimit i këtij ligji e kryejnë funksionin e avokatit publik, vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre deri në skadimin e mandatit për të cilin janë emëruar si avokatë publikë të Republikës së Maqedonisë dhe zëvendës-avokatëve publikë.

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Avokatinë Publike të Republikës së Maqedonisë vazhdojnë të punojnë në Avokatinë Shtetërore në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Pronën e tundshme dhe të patundshme me të cilën disponon dhe e shfrytëzon Avokatia e Republikë së Maqedonisë nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, e merr Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë.

Neni 36

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të marrë Vendim për përcaktimin e numrit të avokatëve shtetërorë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të marrë Vendim për caktimin e selisë të avokatëve shtetërorë dhe rajoneve të gjykatave ku kryhet funksioni i avokatisë shtetërore në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ministri i Drejtësisë do të miratojë Rregulllore për përcaktimin e formularit, përbajtjes, procedurës dhe mënyrës së dhënies, të shfrytëzimit dhe të heqjes së legjitimacionit zyrtar, në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 37

Me ditën e fillimit të zbatimit i këtij ligji pushon të vlefjë Ligji për avokati publike ("Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë" numër 47/1997).

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrta e Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

DISPOZITA	NGA	NJË	LIGJ	TJETËR
Ligj për plotësimin e Ligjit për avokatinë shtetërore ("Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë")		nr.	104/2015)	
Neni				2
Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë obligohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të lidhet në mënyrë elektronike me Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive.				